

# Prezantimi i Konceptit të Përmbarimit Privat në Mbrojtjen e Konkurrencës

Mars 2019



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

---

# Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Është një organizatë e pavarur, jopartiake dhe jo-fitimprurëse e politikave publike me qendër në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ ose trajtojnë problemet në fushat e politikave të lartpërmendura.

Analizë Politikash 03/2019

## Prezantimi i Konceptit të Përmbartimit Privat në Mbrojtjen e Konkurrencës

Autor: Dren Ajeti

Mars 2019

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Mars, 2019.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e stafit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, donatorëve e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
Rr. "Rexhep Luci", 16/1  
Prishtinë 10 000, Kosovë  
Ueb : [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 234 456

*“Ky botim është realizuar me përkrahjen e Agjencionit Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Sida-së, dhe KCSF-së.”*

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

# PREZANTIMI I KONCEPTIT TË PËRMBARIMIT PRIVAT NË MBROJTJEN E KONKURRENCËS

## 1. Hyrje

Mbrojtja e tregut të lirë dhe konkurrencës sot paraqet bërthamën e Bashkimit Evropian. Respektimi i parimeve të konkurrencës së lirë ka siguruar jo vetëm hapjen e tregjeve kombëtare, por njëherësh ka mundësuar edhe bashkëpunimin në fusha të tjera politike.<sup>1</sup>

Rëndësia e mbrojtjes së konkurrencës në BE shihet më së miri në kompetencat që shtetet anëtarë ia kanë besuar Komisionit Evropian përkitazi me ruajtjen e konkurrencës si dhe aktivitetin e shtuar të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe ligjdhënësit evropian në këtë fushë.<sup>2</sup> Rëndësia që BE dhe shtetet anëtare i kanë kushtuar mbrojtjes së konkurrencës, shihet edhe në pozitën e kësaj fushe në procesin integruar të vendeve aspirante për t'u bërë pjesë e BE-së. Të gjitha Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit të nënshkruara me vendet aspirante si Serbia<sup>3</sup>, Kroacia (sot shtet anëtar)<sup>4</sup> apo Shqipëria<sup>5</sup>, i kanë kushtuar rëndësi mbrojtjes së konkurrencës, gjegjësisht ndalimit dhe pengimit të formave të marrëveshjeve të cilat do ta çrregullonin tregun, por edhe dhe përafrimit me acquis në këtë fushë. Si shteti i fundit, Kosova më 2 nëntor 2015 ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.<sup>6</sup> Si palë nënshkruese, Republika e Kosovës ka marrë përsipër detyrimin e përafrimit të legjislacionit të saj kombëtar me atë të acquis në fushën e mbrojtjes së konkurrencës dhe tregut të lirë.<sup>7</sup> Siç do të shohim më poshtë, mbrojtja e konkurrencës, gjegjësisht luftimi i marrëveshjeve të ndaluara të cilat kanë për synim çrregullimin e konkurrencës, sot zhvillohet në dy drejtime: atë publik-administrativ dhe privat-civil (e njohur si përmbarimi privat). Në Kosovë ndërkaq, ligji për mbrojtjen e konkurrencës njihet vetëm mbrojtjen e konkurrencës nga aspekti publik, ani pse ka zëra që përmbarimi privat mund të ushtrohet përmes pasurimit të pabazë. Përkundër kësaj, nuk njihet asnjë rast i ushtruar në gjykatat e Kosovës përkitazi me dëmet e shkaktuara nga marrëveshjet e ndaluara.

Ky studim ka për qëllim që të analizoj mbrojtjen e konkurrencës në BE duke vënë theksin te luftimi privat civil (përmbarimi privat) dhe zhvillimet e ndodhura viteve të fundit në këtë fushë. Këto zhvillime do të analizohen me qëllim që të shihet se si ato mund të inkorporohen në legjislacionin kombëtar, përkatësisht se si përmbarimi privat mund të ndihmoj Autoritetin e Konkurrencës në mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë. Në fund, GSJP do të ofroj disa rekomandime që do të duhej të merreshin parasysh nga ligjvënësi dhe autoriteti i konkurrencës, për të forcuar mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë.

## 2. Mbrojtja e konkurrencës nga marrëveshjet e ndaluara

### a) Mbrojtja e konkurrencës në përgjithësi

Konkurrenca mund të ekzistoj vetëm në vendet me ekonomi të tregut të lirë dhe lind atëherë kur subjektet e së drejtës shfrytëzojnë lirinë e tyre të veprimit<sup>8</sup>. Por, a ka definim të saktë të konkurrencës? Për shkak të kompleksitetit- të gjithë tentimet për një definim të saktë të termit “konkurrencë” kanë dështuar. Megjithatë, konkurrenca dallohet me disa tipare që e karakterizojnë dhe mbi bazën e të cilave mund të kuptojmë më për së afërmi këtë term<sup>9</sup>.

<sup>1</sup>Thomas, S (2011). Der Schutz des Wettbewerbs in Europa – Welcher Zweck heiligt die Mittel?. Juristische Zeitschrift. f. 485.

<sup>2</sup>Ibid.

<sup>3</sup>Shiko: SAA Serbia. Title VI,

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/serbia/key\\_document/saa\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/serbia/key_document/saa_en.pdf).

<sup>4</sup>SAA Croatia. Title VI,

<http://ec.europa.eu/eroid/agreements/downloadFile.do?fullText=yes&treatyTransId=584>.

<sup>5</sup>SAA Albania, Title VI,

<http://ec.europa.eu/world/agreements/downloadFile.do?fullText=yes&treatyTransId=13127>.

<sup>6</sup> Law No. 05/L -069 on Ratification of the Stabilization and Association Agreement, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>.

<sup>7</sup>Article 74-75, Laë No. 05/L -069 on Ratification of the Stabilization and Association Agreement, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>.

<sup>8</sup>Kling M/Thomas S (2016). Kartellrecht. München. f. 4

<sup>9</sup> Kling M/Thomas S (2016). Kartellrecht. München. f. 5-6.

Tiparet e përbashkëta të konkurrencës janë:

- ekzistimi i tregjeve,
- me së paku dy kërkues ose ofertues.
- që kanë sjellje antagoniste (jo bashkëpunuese) ndërmjet tyre, duke tentuar të përmirësojnë pozicionin e tyre në kurriz të të tjerëve<sup>10</sup>.

Me ekzistimin e konkurrencës në tregun e lirë, përfitimet janë të shumta dhe të shumëllojshme. Në radhë të parë, ekzistimi i shumë pjesëmarrësve në treg ndikon që produktet dhe shërbimet e ofruara në treg të jenë gjithnjë të kualitetit më të mirë, ngase blerësit kanë mundësi që produktin ose shërbimin e dëshiruar ta gjejnë në mesin e shumë ofertuesve të ndryshëm. Nga ky numër i madh i ofertuesve, blerësit kanë mundësi të zgjedhin ofertuesin që ofron produktin ose shërbimin më të lirë. Konkurrenca pra ndikon në uljen e çmimit për produkt dhe shërbim. Për t`i ikur këtij presioni të vazhdueshëm, ofertuesit në treg/ndërmarrjet shpesh bëjnë marrëveshje të ndryshme me të cilën mundohen të eliminojnë konkurrencën ndërmjet tyre, duke përcaktuar kështu çmimet për produktet, ndarjen regjionale të tregjeve, sasinë e prodhimit etj.

Me marrëveshje të ndaluara kuptojmë “marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut<sup>11</sup> të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant”<sup>12</sup>. Veçanërisht të ndaluara janë marrëveshjet e njohura si “kartele hardcore”<sup>13</sup> që kanë për synim fiksimin e çmimeve të blerjes ose shitjes, kufizimin ose kontrollin e prodhimit, tregjeve, zhvillimin teknik ose investimet, apo ndarjen e tregjeve ose burimet e furnizimit. Marrëveshjet e tilla që nga fillimi vlerësohen si të pavlefshme, ngase kanë për synim të shuajnë ose kufizojnë tregun. Ndryshe, marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve njihen edhe si kartele, prandaj këto dy terme në punim do të përdoren sinonimisht.

Marrëveshjet e ndaluara rregullisht sjellin çmime të fryra dhe ulje të kualitetit të produkteve ose shërbimeve dhe zbehin fuqinë inovative të ndërmarrjeve duke i shkaktuar kështu dëme ekonomisë dhe veçanërisht konsumatorëve.<sup>14</sup> Për shkak të dëmeve të shumta që mund të shkaktojnë marrëveshjet e tilla, shteti është i interesuar që të mbroj një treg të lirë me konkurrencë të drejtë. Për këtë qëllim, janë themeluar organe administrative qëllimi i të cilave është zbulimi, shuarja e karteleve dhe sanksionimi i ndërmarrjeve të përfshira në kartel.

## **b) Mbrojtja e konkurrencës në BE dhe shteteve anëtare të BE-së**

### **Mbrojtja e konkurrencës nga organet administrative**

Siç u cek në fillim, konkurrenca sot paraqet bërthamën ekonomike dhe politike të Bashkimit Evropian. Luftimi i marrëveshjeve të ndaluara/ karteleve në BE dhe vendet anëtare të saj, tradicionalisht zhvillohet në procedurë administrative nga autoritete përkatëse administrative përmes zbulimit, ndalimit dhe shqiptimit të gjobave. Luftimi administrativ i marrëveshjeve të ndaluara në BE është kompetencë e Komisionit Evropian. Rëndësia që BE i ka kushtuar mbrojtjes së konkurrencës, shihet në aktivitetin e shtuar të Komisionit Evropian përkitazi me zbulimin dhe sanksionimin e karteleve si dhe në aktivitetin e shtuar të Gjykatës së Lartë Evropiane në zhvillimin

<sup>10</sup> Më gjërësisht për termin konkurrencë shih: Mestmäcker E. Zwischen Lämmerweide und Wolfsrudel-Gedanken zur Naturgeschichte des Wettbewerbs. Zeitschrift für Wettbewerbsrecht. V. 1/2010.

<sup>11</sup> Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 2.1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326>.

<sup>12</sup> Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 4.1. [gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326).

<sup>13</sup> Të cekura decidivisht në nenin 4.1 të Ligjit Nr 04/L-226. [gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326)

<sup>14</sup> Bundeskartellamt. Kartellverbot. Bundeskartellamt.

[bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Broschueren/InformationsbroschueC3%BCre%20-%20Erfolge%20Kartellverfolgung.html;jsessionid=C45BC054BAAE9F62D6269CB0D5B4A041.2\\_cid387?nn=3591496](https://www.bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Broschueren/InformationsbroschueC3%BCre%20-%20Erfolge%20Kartellverfolgung.html;jsessionid=C45BC054BAAE9F62D6269CB0D5B4A041.2_cid387?nn=3591496)

e jurisprudencës përmes vendimeve të saja. Statusi kushtetues që i është dhënë kësaj fushe<sup>15</sup> dhe intensiteti ligjdhënës, ka bërë që mbrojtja e konkurrencës të jetë ndër fushat më të rregulluara dhe të harmonizuara brenda *acquis* së BE-së dhe shteteve anëtare të saj. Komisioni Evropian nga viti 1990 deri më sot ka zbuluar dhjetëra karte të shtrira në dy ose më shumë shtete anëtare. Komisioni ndërmarrjet e përfshira në kartel deri më tani i ka sanksionuar me gjithsej 26.748.810.000 Euro, nga të cilat vetëm në katër vitet e fundit janë shqiptuar gjoja në lartësi prej 8.472.206.000 Euro.<sup>16</sup> Për marrëveshjet e ndaluara, pasojat e së cilës shfaqen vetëm në një treg kombëtar, gjegjësisht lokal, kompetente për hetimin, ndalimin dhe sanksionimin e ndërmarrjeve të përfshira në një kartel, janë autoritetet kombëtare të konkurrencës.<sup>17</sup> Nga këto autoritete janë zbuluar dhjetëra karte të shqiptuar miliarda euro gjoja. Autoriteti Gjerman i Konkurrencës për tre vite (2014-2016) ka zbuluar disa karte, duke gjobitur ndërmarrjet me gjoja në lartësi prej 1,452,600,000 Euro<sup>18</sup>, në Austri në vitin 2016 janë shqiptuar gjoja në vlerë prej 18.6 milion Euro<sup>19</sup>, ndërkaq në Francë në vitin 2015 u shqiptuan gjoja në lartësi rekorde prej 1.25 miliardë Euro<sup>20</sup>. Aktiviteti i shtuar i autoriteteve të konkurrencës duhet të shikohet edhe nën frymën e ashpërsimit të konkurrencës botërore, e cila nuk lejon krijimin e karteleve, pasi të njëjtat janë pengesa të zhvillimit të inovacionit dhe konkurueshmërisë së tregjeve të një vendi.

### **Mbrojtja e konkurrencës në përbarimin privat**

Në vitet e fundit, përveç luftimit administrativ të karteleve, është pranuar edhe e drejta e çdo individi për të kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga një marrëveshje e ndaluar. Që nga vendimi *Courage*<sup>21</sup> dhe *Manfredi*<sup>22</sup>, Bashkimi Evropian këtë drejtë e njeh edhe në nivel evropian. Nga miratimi i Direktivës së BE-së Nr. 2014/104/EU në vitin 2014, kjo e drejtë tani unanimisht njihet edhe në të gjitha legjislacionet e vendeve anëtare.<sup>23</sup> Çdo person, fizik ose juridik ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në një marrëveshje të ndaluar. Njohja e kësaj të drejte ka ndikuar që krahas luftimit administrativ të marrëveshjeve të ndaluara, përbarimi privat të ndihmojë të paraqitet si një mekanizëm mbështetës në luftimin e karteleve.

### **c) Mbrojtja e konkurrencës në Kosovë**

#### **Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

Në vitin 2004 Kuvendi i Kosovës si pjesë e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse, miratoj Ligjin Nr. 2004/36 për Konkurrencën. Ky ligj njihi Komisionin e Konkurrencës si agjenci rregullative për mbrojtjen e Konkurrencës. Pas shpalljes së pavarësisë dhe vendimit të institucioneve që ligjet të harmonizohen pjesërisht ose plotësisht me *acquis* e BE-së, në vitin 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoj Ligjin Nr. 03/L-229 “për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Në vitin 2014 u miratua Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Sot Kosova ka një ligj i cili përgjithësisht është i harmonizuar me *acquis* në fushën e mbrojtjes administrative të konkurrencës, pra mbrojtjes që ofrohet nga autoriteti i

<sup>15</sup> Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Neni 101,102. Verzioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian: [http://mei-ks.net/repository/docs/Traktati\\_i\\_Lisbones\\_-\\_Verzioni\\_i\\_Konsoliduar.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf).

<sup>16</sup> Drejtoria e përgjithshme e Konkurrencës. Cartel Statistics. Komisioni Evropian. <http://ec.europa.eu/competition/cartels/statistics/statistics.pdf>

<sup>17</sup> Për listë të autoriteteve të konkurrencës në Evropë shih: Competition authorities in Europe. Bundeskartellamt. [http://bundeskartellamt.de/EN/AboutUs/LinksAddresses\\_neu/Europe/Europe\\_node.html](http://bundeskartellamt.de/EN/AboutUs/LinksAddresses_neu/Europe/Europe_node.html)

<sup>18</sup> Drucksache 18/12760-Unterrichtung durch die Bundesregierung Bericht des Bundeskartellamtes über seine Tätigkeit in den Jahren 2015/2016 soëie über die Lage und Entëicklung auf seinem Aufgabengebiet und Stellungnahme der Bundesregierung. Deutscher Bundestag. F. VIII, 30. <http://dip21.bundestag.de/dip21/btd/18/127/1812760.pdf>

<sup>19</sup> Tätigkeitsbericht 2016. Bundeswettbewerbsbehörde. F. 3. [http://bwb.gv.at/Documents/Tätigkeitsbericht%202016%20BEB\\_final.pdf](http://bwb.gv.at/Documents/Tätigkeitsbericht%202016%20BEB_final.pdf)

<sup>20</sup> Advocacy for an agile economy-2015 Annual Report Summary. Autorité de la concurrence. F. 7. [http://autoritedelaconcurrence.fr/doc/ra2016\\_uk\\_web.pdf](http://autoritedelaconcurrence.fr/doc/ra2016_uk_web.pdf)

<sup>21</sup> GJED. C-453/09 - Courage.

<sup>22</sup> <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d661b0d856ae014ba3af5ff48cfbefe4d6.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxYMb3r0?text=&docid=46604&pageIndex=0&doclang=DE&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1157115>

<sup>23</sup> GJED. C-295/04 - Manfredi. <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:62004CJ0295:DE:PDF>

<sup>23</sup> Shih: Directive 2014/104/EU of The European Parliament And Of The Council of 26 November 2014 on certain rules governing actions for damages under national law for infringements of the competition law provisions of the Member States and of the European Union, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

konkurrencës. Ligji fare nuk e rregullon mbrojtjen private të konkurrencës, gjegjësisht të drejtën e të dëmtuarve për të kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kartelet.

Mbrojtja e konkurrencës në Kosovë i është besuar Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, i cili është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 dhe ky Autoritet i përgjigjet të fundit. Autoriteti përbëhet nga Kryetari i Komisionit dhe 4 komisionerë të cilët i emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës.<sup>24</sup> Në mungesë të vullnetit politik, Autoriteti për më shumë se tre vite ishte jofunksional në mungesë të zgjedhjes së anëtarëve të bordit.<sup>25</sup> Në qershor të vitit 2016, Kuvendi përfundimisht zgjodhi bordin në krye me Valon Prestreshin si kryetar të Autoritetit.<sup>26</sup> Si rregullator i pavarur, Autoriteti ka përgjegjësinë dhe autoritetin për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe promovimin e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve si dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë. Veçanërisht është i ngarkuar me hetimin, zbulimin dhe ndëshkimin e ndërmarrjeve të përfshira në një marrëveshje të ndaluar, gjegjësisht ndërmarrjet që abuzojnë me pozitën e tyre dominuese.<sup>27</sup>

### Performanca e Autoritetit të Konkurrencës

Dështimi radhazi për tre vite i Kuvendit të Kosovës për të funksionalizuar Autoritetin përmes zgjedhjes së bordit, ka bërë që Autoriteti i Konkurrencës të tregoj performancën më të dobët në mesin e agjencive rregullatore të vendit. Për shkak të fushës që rregullon, ky dështim ka ndikuar edhe në uljen e konkurrenshëmërisë në Kosovë. Kjo ka rezultuar me krijimin e dhjetëra karteleve dhe monopoleve, barrën e së cilës po e bart konsumatori kosovar. Edhe tani, kur Autoriteti është funksionalizuar, ai po ballafaqohet me disa pengesa që po pamundësojnë rritjen e performancës së këtij institucioni. Mungesa e përvojës dhe ekspertizës së anëtarëve të Komisionit, presioni politik, mungesa e mbikëqyrjes parlamentare, buxheti i vogël dhe mungesa stafit hetues janë vetëm disa nga pengesat që po e bëjnë autoritetin të dallohet për numrin e ulët të vendimeve të marra në lidhje me luftimin e marrëveshjeve të ndaluara dhe abuzimit me pozitën dominuese<sup>28</sup>. Pa përmirësimin e pikave të lartshënuara, performanca e Autoritetit do të vazhdojë të mbetet në nivele të ulëta. Prandaj, përforsimi i punës së autoritetit përmes përmbartimit privat do të paraqiste një mbështetje të madhe në punën e këtij institucioni, ashtu siç ndodh në vendet e tjera.

## 3. Përmbartimi Privat

### Çka është përmbartimi privat?

Siç tregojnë një sërë studimesh të ndryshme, me rritjen e tregjeve dhe numrin e ndërmarrjeve, autoritetet e konkurrencës në Evropë dhe gjetiu janë të stërngarkuara në luftimin e karteleve dhe abuzimit me pozitën dominuese.<sup>29</sup> Kjo e ka bërë të nevojshme gjetjen e mekanizmave të tjerë me të cilët do të mund të bëhej parandalimi dhe ndëshkimi i ndërmarrjeve të përfshira në kartele. Autoritetet e konkurrencës synim kryesor e kanë ruajtjen e konkurrencës si vlerë të pandashme të lirisë, por edhe si mekanizëm për ruajtjen e efikasitetit të tregut<sup>30</sup>, përderisa mbrojtja e të dëmtuarve nga karteli ka mbetur deri vonë e parregulluar. Me kohë është kuptuar se rregullimi i fushës së kompensimit të dëmit i të dëmtuarve nga një kartel, nuk i shërben vetëm të dëmtuarit, por edhe mbrojtjes më të mirë të konkurrencës. Sot, luftimi i marrëveshjeve të ndaluara nuk bëhet vetëm përmes sanksioneve administrative të shqiptuara nga organet administrative, por është ngritur edhe në një nivel të luftimit juridik-civil apo ndryshe e njohur si përmbartimi privat.

<sup>24</sup> Rreth nesh. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,11>

<sup>25</sup> Autoriteti i Konkurrencës, tri vjet pa bord. Gazeta Zëri. <http://zeri.info/ekonomia/72647/autoriteti-i-konkurrencës-tri-vjet-pa-bord/>

<sup>26</sup> Valon Prestreshi - Kryetar i Komisionit, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,23,57>

<sup>27</sup> Neni 4 dhe 11, Ligji Nr. 03/L – 229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2727>

<sup>28</sup> Shih më gjërësisht: Elshani D, Pula E, Ajeti D (2017). The Performance of the Kosovo Competition Authority. Policy Paper. Group for Legal and Political Studies. <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2017/10/GLPS-Policy-Report-KCA-Performance.pdf>

<sup>29</sup> Emmerich V (2014). *Kartellrecht – Ein Studienbuch*. München. F. 100.

<sup>30</sup> Më gjërësisht: Thomas S. Der Schutz des Wettbewerbs in Europa – Welcher Zweck heiligt die Mittel. *JuristenZeitung* 10/2011. f. 486.



## Funksionet e përbarimit privat

Përbarimi privat kryen një sërë funksionesh në mbrojtjen e konkurrencës. Funksionet kryesore megjithatë janë funksioni i kompensimit të dëmit<sup>31</sup>, funksioni parandalues<sup>32</sup> dhe funksioni i plotësimit të veprimeve të autoritetit të konkurrencës<sup>33</sup>. Me funksionin e kompensimit të dëmit synohet kompensimi i plotë i dëmit për personat të cilët kanë pësuar dëm nga një marrëveshje e ndaluar.<sup>34</sup> Përderisa në të drejtën e deliktit, kompensimi i të dëmtuarit paraqet qëllimin kryesor, në të drejtën e konkurrencës ky funksion ka për qëllim që të parandaloj/paralajmëroj ndërmarrjet të marrin pjesë në kartelet.<sup>35</sup> Nga hija e funksionit kompensues paraqitet pra edhe funksioni parandalues. Përmes zbatimit të së drejtës së të dëmtuarve për të kërkuar kompensimin e dëmit nga ndërmarrjet në kartel, synohet që arritja e një marrëveshje të ndaluar të bëhet e paleverdishme<sup>36</sup>. Kjo për faktin se përveç frikës së gjobitjes nga autoriteti i konkurrencës<sup>37</sup>, shkelësit e ligjit të konkurrencës<sup>38</sup> duhet të frikësohen edhe nga padi të panumërta nga blerësit që kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale me ndërmarrjet e përfshira në kartel, gjegjësisht çdokush që ka pësuar nga kjo marrëveshje e ndaluar<sup>39</sup>. Përbarimi privat gjithashtu mbështet autoritetet e konkurrencës në punët e tyre<sup>40</sup>, duke lehtësuar punën e tyre përmes padive civile dhe njëherësh duke zhvilluar praktikën gjyqësore në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës (funksioni mbështetës).<sup>41</sup>

## 4. Shkaktimi i dëmit nga marrëveshjet e ndaluara sipas së drejtës së BE-së

Siç u cek në hyrje të punimit, qëllimi i këtij punimi është analizimi i përbarimit privat në BE dhe mundësia që kjo e drejtë të pranohet edhe në të drejtën kosovare të konkurrencës. Për këtë qëllim, kjo pjesë do të analizoj llojet e dëmeve që shkaktohen nga marrëveshjet e ndaluara, legjitimitetin aktiv dhe pasiv si dhe disa çështje të rëndësishme procedurale..

### Llojet e shkaktimit të dëmit nga kartelet

Sipas një studimi të vitit 2015, ekonomistët Boyer dhe Kotchoni vijnë në përfundim se nga marrëveshjet e ndaluara, çmimi i produkteve dhe shërbimeve në tregun e karteluar rritet për mesatarisht 15%.<sup>42</sup> Nga kjo rritje, ndërmarrjet tjera, veçanërisht blerësit, pësojnë dëme të pakthyeshme, kompensimi i të cilave mund të kërkohej vetëm nga të dëmtuarit. Me shprehjen dëm kuptojmë zvogëlimin e pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimin e rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimin e dhembjes fizike të tjetrit, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)<sup>43</sup> si rezultat i shkeljes së një dispozite ligjore ose kontraktuale që mbron një të mirë juridike. Në rastin e së drejtës së konkurrencës, e mira juridike që mbrohet është konkurrenca dhe pjesëmarrësit në të. Rrjedhimisht, me shkeljen e dispozitave të Ligjit për Konkurrencën kemi shkelje të mbrojtjes së konkurrencës dhe pjesëmarrësve në të.

<sup>31</sup>Ibid

<sup>32</sup>Schmidt C (1977). *Kartellverfahrensrecht-Kartellverwaltungsrecht*. Köln, f.328,329.

<sup>33</sup>Bundeskartellamt. *Private Kartellrechtsdurchsetzung – Stand, Probleme, Perspektiven – Diskussionspapier für die Sitzung des Arbeitskreises Kartellrecht am 26. September 2005*. Bundeskartellamt. [bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions\\_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?\\_\\_blob=publicationFile&v=4](https://www.bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?__blob=publicationFile&v=4)

<sup>34</sup>Krüger H (2007). *Öffentliche und private Durchsetzung des Kartellverbots von Art. 81 EG*. Eiesbaden. f. 212.

<sup>35</sup>Poelzig D (2012). *Normdurchsetzung durch Privatrecht*. Tübingen. F. 172.

<sup>36</sup>Ibid.

<sup>37</sup>Në Kosovë, për shkelje të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, një ndërmarrje nuk mund të ndëshkohet me gjobë që tejkalon shumën prej 10 % të totalit të të hyrave që ndërmarrja ka realizuar në tri vitet e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar. Më gjërësisht shiko neni 56, Ligji Nr. 03/L –229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2727>

<sup>38</sup>Shprehja “shkelës” do të përdoret si sinonim për ndërmarrjet pjesëmarrëse në marrëveshje të ndaluara/kartelet.

<sup>39</sup>Komisioni Evropian, *Grünbuch Schadenersatzklagen wegen Verletzung des EU-Wettbewerbsrechts*. Komisioni Evropian. f. 4. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/PDF/?uri=CELEX:52005DC0672&from=DE>

<sup>40</sup>Ajeti D (2016) *Schadenersatz für Preisschirmschäden im Kartellrecht: Preisschirmschäden im deutschen und europäischen Kartellrecht*. AV Akademikerverlag. f. 5,6.

<sup>41</sup>Bundeskartellamt. *Private Kartellrechtsdurchsetzung – Stand, Probleme, Perspektiven – Diskussionspapier für die Sitzung des Arbeitskreises Kartellrecht am 26. September 2005*. Bundeskartellamt. F. 3.

[bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions\\_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?\\_\\_blob=publicationFile&v=4](https://www.bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?__blob=publicationFile&v=4)

<sup>42</sup>Boyer M/Kotchoni R (2015). How much do cartels overcharge?. *CIRANO Scientific Series*. F. 28-29.

<https://irano.qc.ca/files/publications/2015s-37.pdf>


<sup>43</sup>Neni 137.1, Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

## Dëmet e shkaktuara direkt të pjesëmarrësve në treg dhe konkurrentët e ndërmarrjeve të përfshira në kartel

Qëllimi i karteleve është rritja e fitimeve ekonomike. Duke mos marrë parasysh se për çfarë është arritur marrëveshja (ngritja e çmimeve, ulja e prodhimit, ndarja gjeografike e tregjeve), qëllimi përfundimtar është rritja e fitimeve për ndërmarrjet e përfshira në kartel. Zakonisht, çmimi i ngritur i bartet blerësit i cili direkt blen produktin ose shërbimin nga ndërmarrja e përfshirë në kartel. Me këtë rast, blerësi gjendet para dy situatave: Situata e parë, në të cilin nga frika e ikjes së klientëve të tij, çmimin e rritur e mban për vete, me ç'rast i shkaktohet dëm i zvogëlimit të pasurisë, dhe situata e dytë, ku nga bartja e çmimit të rritur te klientët e tij, këta të fundit nuk pranojnë më produktin ose shërbimin e tij, duke ikur drejtë ndërmarrjeve që ofrojnë produktin ose shërbimin më të lirë, pra duke i shkaktuar atij humbje të mëdha në fitim. Në të dyja rastet, blerësi direkt nga ndërmarrja e përfshirë në kartel, pëson dëme të cilat i janë shkaktuar atij si rezultat i një marrëveshje të ndaluar. Gjithashtu, ndërmarrjet konkurrencte të ndërmarrjeve të përfshira në kartel mund të pësojnë dëme nga marrëveshja e ndaluar. Kështu p.sh. ndërmarrjet konkurrencte mund të pësojnë nga marrëveshja e ndaluar e disa ndërmarrjeve për t`i ulur çmimet, me ç'rast ndërmarrjet e pa përfshira në kartel do të ballafaqoheshin me detyrimin për t`i ulur çmimet që të mos kenë humbje të klientëve të tyre, çmim ky që nuk do të ofrohej në një treg me konkurrencë të rregullt. Nën vendimin Courage “çdo individ” që i shkaktohet dëm nga këto marrëveshje ka të drejtën e kompensimit të dëmit, pra edhe ndërmarrjet konkurrencte në treg.

### Dëmet e shkaktuara nga “passing on defense”

Që nga vendimi i GJED-së në rastin Courage<sup>44</sup> dhe Manfredi<sup>45</sup>, në të drejtën e BE-së dhe shteteve anëtare është njohur e drejta e “çdo individ” për të kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga një kartel. Mirëpo, kjo e drejtë u njihet vetëm atyre që kanë pësuar në kausalitet dhe direkt nga ndërmarrja e përfshirë në marrëveshje të ndaluar. Megjithatë, ka raste të shpeshta, kur çmimi i rritur si shkak i kartelit bartet në pjesëmarrësin tjetër në treg – i ashtuquajtur i efekti i passing-on defense. Me passing-on defense apo bartja e dëmit bëhet fjalë kur subjekti/blerësi i cili direkt furnizohet nga ndërmarrja e përfshirë në kartel, çmimin e ngritur si pasojë të kartelit apo abuzimit e bartë tërësisht apo pjesërisht në subjektet/blerësit pasues të zingjirit (blerësi indirekt).



Për ta bërë më të qartë mënyrën e shkaktimit të dëmit, në vazhdim paraqesim një shembull: Prodhuesi A që është pjesë e një karteli, së bashku me ndërmarrjet tjera vendos që të rrisë çmimin e produktit të tij për rreth 15%. Kështu, produktin e tij, ai i'a shet me shumicë ndërmarrjes tregtare B me 15% rritje të çmimit. Firma B në anën tjetër, duke e ditur që shitja e produktit me 15% rritje është e vështirë dhe që njëherësh rrezikon edhe humbjen e klientëve, i njëjti vendos që klientëve siç është klienti C, t`ia shet produktin, duke përcjellë në të vetëm 8% të çmimit të rritur. Ndërmarrja C në anën tjetër ia shet konsumatorit të fundit produktin me 6% çmim të rritur, duke mbajtur për vete 2% të çmimit të rritur. Siç shihet, në rastin konkret kemi një bartje të çmimit, me ç'rast nuk po dëmtohet vetëm konsumatori i fundit, por të gjithë blerësit në zinxhirin e shitjes. Kështu kemi një shpërndarje të dëmit të shkaktuar nga marrëveshja e ndaluar e kartelit.

Përfundimisht me kapitullin IV të Direktivës së BE-së<sup>46</sup> është njohur efekti i bartjes së dëmit në të drejtën e konkurrencës, duke rregulluar edhe të drejtën e padisë dhe llogaritjes së dëmit të tillë.

<sup>44</sup> GJED. C-453/99-Courage. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:61999CJ0453&from=EN>

<sup>45</sup> GJED. C-295/04- Manfredi.

<http://curia.europa.eu/juris/shoëPdf.jsf?text=&docid=56474&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=625262>

<sup>46</sup>Direktiva Nr. 2014/104/BE. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

## Dëmet e shkaktuara nga efekti i “Umbrella Pricing”

Siç u cek më lartë, *acquis* e BE-së dhe shteteve anëtare të BE-së, përmes burimeve primare dhe sekondare ka njohur të drejtën e blerësve direkt dhe indirekt për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ndërmarrjet e përfshira në kartel dhe ndërmarrjet që kanë abuzuar me pozitën e tyre dominuese. Mirëpo, shkencë ekonomike dhe juridike ka vërejtur edhe disa efekte anësore të shkaktuara nga krijimi i karteleve dhe abuzimit me pozitën dominuese në treg, të cilat shkencat e lartshënuara i kanë emëruar si Umbrella-pricing (shqip: Efekti i çmimit ombrellë). Për Umbrella-pricing bëhet fjalë kur një ndërmarrje në treg e cila nuk është përfshirë në një marrëveshje të ndaluar (ndërmarrje jashtë kartelit), duke vërejtur rritjen e çmimeve si pasojë e kartelit, ngrit çmimet e produktit apo shërbimit të tij.<sup>47</sup> Umbrella pricing paraqitet në tregjet ku një pjesë e tregut nuk është përfshirë nga karteli, mirëpo tërthorazi shënon rritje të çmimit.<sup>48</sup> Rritja e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të shkaktuara nga kartelet krijon një “Ombrellë” nën të cilën ndërmarrjet jashtë kartelit përfitojnë nga rritja e çmimeve dhe rrjedhimisht mundësia për të rritur profitin<sup>49</sup>-pra futën nën mbrojtjen e ombrellës së kartelit pa qenë pjesë direkte apo indirekte e një marrëveshje të ndaluar. Ndërmarrjet e tilla zakonisht janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme me një relevancë të vogël në treg, të cilët shohin dhe shfrytëzojnë mundësitë e maksimizimit të profitit të tyre.<sup>50</sup> Me rritjen e çmimeve të produkteve të ndërmarrjeve që janë pjesë e marrëveshjes së ndaluar, kërkesa e blerësve nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të kartelit fillon të bartet tek ndërmarrjet jashtë kartelit, me ç'rast këto ndërmarrje ballafaqohen me kërkesë në rritje për produktet e tyre, dhe duke iu nënshtruar ligjit të “kërkesës dhe ofertës” fillojnë të rrisin çmimet e tyre.<sup>51</sup> Kështu, nën efektin e umbrella-pricing edhe blerësit direkt dhe indirekt të ndërmarrjeve jashtë kartelit pësojnë dëm si shkak i një marrëveshje të ndaluar/kartelit. Deri në vitin 2014, as BE dhe as ndonjë shtet anëtar i BE-së nuk ka njohur dhe pranuar dëmet e shkaktuara nga efekti umbrella pricing.

Sipas juristëve, në dëmet e tilla mungon lidhja kausale ndërmjet veprimit të ndaluar dhe dëmit të shkaktuar, pasi ndërmjet shkeljes së ligjit dhe dëmit të shkaktuar ekziston një ngjarje e tretë (veprimi i ndërmarrjes jashtë kartelit për të rritur çmimin), me ç'rast paraqitet një shkëputje e kausalitetit.<sup>52</sup> Këtë argument, Gjykata Evropiane e Drejtësisë në vitin 2014 në rastin *Kone* përfundimisht e hedh poshtë si të pabazuar, duke pranuar kështu edhe dëmet e umbrella pricing dhe të drejtën e kompensimit të tyre nga ndërmarrjet në kartel.<sup>53</sup> Shtetet e BE-së këtë vendim tani kanë filluar së implementuari në të drejtën kombëtare.

Ndërmarrjet e përfshira në kartel, si rezultat i një marrëveshje të ndaluar, shkaktojnë një sërë dëmsh të ndryshme të cilat përveç blerësve direkt, u shkaktojnë dëm edhe blerësve indirekt (bartja e dëmit), por edhe blerësve që fare nuk kanë të bëjnë me ndërmarrjet e përfshira në kartel (umbrella pricing). Praktika gjyqësore evropiane dhe direktiva e BE-së nr. 2014/104 përfundimisht i kanë njohur këto dëme si rezultat i marrëveshjeve të ndaluara. Njohja e këtyre dëmeve dhe mbi të gjitha, njohja e së drejtës së dëmshpërblimit për to, është një arritje e madhe dhe ndikon edhe në mbrojtjen e konkurrencës në përgjithësi. Kosova ende nuk e ka të rregulluar këtë fushë. Njohja e dëmeve të shkaktuara nga marrëveshjet e ndaluara, veçanërisht të bartjes së dëmit dhe umbrella pricing, gjithashtu do të shërbente mbrojtjes më të mirë të konkurrencës. Veçanërisht efekti praktik i nenit 4.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës do të ishte i kufizuar në rast se jo çdo individ të ketë të drejtën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga një marrëveshje e ndaluar. Njohja e dëmeve të tilla nuk paraqet asnjë ngarkesë buxhetore apo administrative, pasi ato janë

<sup>47</sup> Bundeskartellamt. *Private Kartellrechtsdurchsetzung Stand, Probleme, Perspektiven*. 2005, F. 3-4, [https://bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions\\_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?\\_\\_blob=publicationFile&v=4](https://bundeskartellamt.de/SharedDocs/Publikation/DE/Diskussions_Hintergrundpapier/Bundeskartellamt%20-%20Private%20Kartellrechtsdurchsetzung.pdf?__blob=publicationFile&v=4)

<sup>48</sup> Ajeti D (2016). *Schadensersatz für Preisschirmschäden im Kartellrecht: Preisschirmschäden im deutschen und europäischen Kartellrecht*. AV Akademikerverlag, F. 6.

<sup>49</sup> Beth H/ Pinter C. Preisschirmeffekte: Ökonomische Implikationen für kartellrechtliche Bußgeld- und Schadensersatzverfahren. *Wirtschaft und Wettbeerb*. 2013, F. 229.

<sup>50</sup> Logemann H (2009). *Der kartellrechtliche Schadensersatz : die zivilrechtliche Haftung bei Verstößen gegen das deutsche und europäische Kartellrecht nach Ergehen der VO (EG) Nr. 1/2003 und der 7. GEB-Novelle*, Berlin. F. 237.

<sup>51</sup> Inderst R/Thomas S (2015). *Schadensersatz bei Kartellverstößen*. F. 306.

<sup>52</sup> Alexander Ch (2010). *Schadensersatz und Abschöpfung*. F. 388-389.

<sup>53</sup> GJED. C-557/12- *Kone*.

<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=153312&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1078732>

të natyrës civile. Dhe mbi të gjitha, njohja e dëmeve të shkaktuara nga marrëveshjet e ndaluara ka për synim që të mundësoj kompensimin e dëmeve që u shkaktohen ndërmarrjeve dhe konsumatorëve nga një marrëveshje e ndaluar. Ligjdhënësi ka për obligim që të krijoj bazën ligjore përmes së cilës çdo person në Kosovë, qoftë ai fizik ose juridik, i mundësohet që të kërkoj rikthimin në gjendje të mëparshme të pasurisë së dëmtuar si rezultat i shkeljes së ligjit.

## 5. Legjitimiteti pasiv dhe aktiv

Në këtë pjesë të punimit do të analizohet se kush ka të drejtë të kërkoj shpërblimin e dëmit (legjitimiteti aktiv) dhe ndaj kujt duhet të drejtohet kjo kërkesë (legjitimiteti pasiv). Legjitimiteti aktiv është e drejta e personit të cilit i është shkelur një e drejtë, që në procedurë gjyqësore të kërkoj realizimin e asaj të drejte. I legjitimuar pasiv është personi ndaj së cilit drejtohet kërkesa.<sup>54</sup>

### Legjitimiteti aktiv

Që nga vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në rastin *Courage, Manfredi, Kone* dhe tani edhe me direktivën nr. 2014/104/BE, legjitimiteti aktiv tani i njihet çdo personi i cili ka pësuar dëm si rezultat i shkeljes së dispozitave të së drejtës së konkurrencës<sup>55</sup>. Përgjithësisht mund të thuhet se dëmet paraqiten në dy nivele: atë horizontal, pra ndërmjet konkurrentëve, dhe vertikal- nga blerësit e ndërmarrjeve të përfshira në kartel<sup>56</sup>. Duke u bazuar në llojet e dëmeve të shkaktuara dhe të shpjeguara më lartë, mund të identifikojmë katër lloje të të dëmtuarve dhe rrjedhimisht të legjitimuarve aktiv: konkurrentët, blerësit direkt, indirekt, dhe të dëmtuarit nga ndërmarrjet e papërfshira në kartel.

Në grupin e parë bëjnë pjesë konkurrentët e ndërmarrjeve të përfshira në kartel. Këta kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin e dëmit që u është shkaktuar si rezultat i shkeljes të së drejtës së konkurrencës. Në grupin e dytë të të dëmtuarve hyjnë ndërmarrjet që janë dëmtuar direkt nga ndërmarrjet në kartel, ndryshe të njohur si blerës direkt. Sipas Direktivës nr. 2014/104/BE, blerës direkt është çdo person fizik ose juridik që ka blerë një produkt ose shërbim nga një shkelës i ligjit, produkt ose shërbim që është objekt i shkeljes së dispozitave të së drejtës së konkurrencës.<sup>57</sup> Në grupin e tretë të të legjitimuarve hyjnë të gjithë blerësit që kanë pësuar dëme indirekte. Direktiva Nr. 2014/104/BE me blerës indirekt nënkupton një person fizik apo juridik që produktin apo shërbimin nuk e blen direkt nga një shkelës i ligjit (ndërmarrje pjesëmarrëse në kartel apo abuzues me pozitën dominuese), por nga një blerës direkt apo blerës pasues, ku produkti apo shërbimi ishte objekt i shkeljes së ligjit të konkurrencës ose produkte përmbajnë në vete shkelje ligjore apo rrjedhin nga një shkelje e tillë".<sup>58</sup> Ndërkaq në grupin e katërt përfshihen të gjithë blerësit që kanë pësuar nga efekti i umbrella-pricing, gjegjësisht blerësit që kanë blerë produkte ose shërbime nga ndërmarrjet që nuk janë përfshirë në një kartel, por që nën përcjelljen e çmimeve të karteluara, kanë ngritur edhe çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

### Legjitimiteti pasiv

Në vija të trasha është shpjeguar se si BE dhe vendet anëtare të saj, përmes përmbarimit privat kanë arritur të forcojnë luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara dhe abuzimit me pozitën dominuese, duke rritur numrin e të legjitimuarve aktiv për të kërkuar të drejtën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar, tani shtrohet pyetja se si ndërmarrjet e përfshira në një marrëveshje të ndaluar apo ndërmarrjet që abuzojnë me pozitën dominuese do të mbahen përgjegjës para të dëmtuarit?

E drejta e BE-së e ka rregulluar fushën e përgjegjësisë civile së shkelësve të dispozitave ligjore përkitazi me të drejtën e konkurrencës. Para së gjithash duhet shikuar se çfarë kuptojmë me ndërmarrje. Ndërmarrja në të drejtën e konkurrencës dallon nga termi ndërmarrje në të drejtën

<sup>54</sup>Aktivlegitimation. JuraForum. [juraforum.de/lexikon/aktivlegitimation](http://juraforum.de/lexikon/aktivlegitimation)

<sup>55</sup>Neni 3.1. Direktiva Nr. 2014/104/BE.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>56</sup>Inderst R/ Maier-Rigaud F/ Schalbe U (2013). Quantifizierung von Schäden durch Wettbewerbsverstöße. F. 12 f. [http://www2.wiwi.uni-](http://www2.wiwi.uni-frankfurt.de/fileadmin/user_upload/dateien_abteilungen/abt_fin/Dokumente/PDFs/Allgemeine_Dokumente/Inderst_Doeloads/Competition_IO/Quantifizierung_von_Schaeden_durch_wettbewerbsverstoesse_2013.pdf)

[frankfurt.de/fileadmin/user\\_upload/dateien\\_abteilungen/abt\\_fin/Dokumente/PDFs/Allgemeine\\_Dokumente/Inderst\\_Doeloads/Competition\\_IO/Quantifizierung\\_von\\_Schaeden\\_durch\\_wettbewerbsverstoesse\\_2013.pdf](http://www2.wiwi.uni-frankfurt.de/fileadmin/user_upload/dateien_abteilungen/abt_fin/Dokumente/PDFs/Allgemeine_Dokumente/Inderst_Doeloads/Competition_IO/Quantifizierung_von_Schaeden_durch_wettbewerbsverstoesse_2013.pdf)

<sup>57</sup>Neni 2.23. Direktiva Nr. 2014/104/BE.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>58</sup>Ibid. Neni 2.24.

tregtare. Sipas Ligjit Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrja është çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist.<sup>59</sup> Në përgjithësi, sipas direktivës Nr. 2014/104/BE, ndërmarrjet e përfshira në kartel mbajnë përgjegjësi solidare për dëmin e shkaktuar përmes kartelit.<sup>60</sup> Kjo përgjegjësi solidare e ka natyrën në të drejtën civile përkitazi me dëmin e shkaktuar, siç është e rregulluar edhe në Ligjin për Marrëdhënien e Detyrimeve<sup>61</sup>. Sipas kësaj, secila ndërmarrje në kartel, në raport të jashtëm, është përgjegjëse për gjithë dëmin e shkaktuar, ndërkaq në raport të brendshëm përgjigjen sipas peshës së fajit dhe pjesëmarrjes në kartel. Megjithatë, ligdhënësi evropian ka paraparë disa përjashtime të caktuara nga përgjegjësia solidare. Kështu, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që gjatë ekzistimit të kartelit zotërojnë më pak se 5% të tregut, mbajnë përgjegjësi vetëm ndaj blerësve të tyre direkt dhe indirekt.<sup>62</sup> Përveç kushtit të zotërimit të ulët në treg, ndërmarrjet e tilla duhet të dëshmojnë që aplikimi i këtyre normave do të paraqiste dëme të pariparueshme për ndërmarrjen dhe rrezikon humbjen e pasurisë së tyre.<sup>63</sup> Kjo rregull nuk vlen në rast se ndërmarrja e cila plotëson kushtet e lartshënuara ka qenë udhëheqëse e kartelit apo edhe recidivist i shkeljes së dispozitave që rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës<sup>64</sup>. Rregullimi i tillë ka për synim që shtyllën e ekonomisë që janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të ruaj nga një mbingarkesë e madhe financiare, e cila do të rezultonte me një humbje të kapaciteteve të saja dhe rrjedhimisht edhe shuarjen e mundshme. Një përjashtim i tillë do të ishte i mirëseardhur edhe për Kosovën, ku shtylla e ekonomisë së vendit janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë pjesën dërrmuese të aktivitetit ekonomik në Kosovë. Përjashtim tjetër nga përgjegjësia solidare është edhe privilegjimi i ndërmarrjes në kartel që ka zbuluar marrëveshjen e ndaluar. Përderisa e drejta e BE-së, e vendeve anëtare, por edhe legjislacioni kosovarë e njohin privilegjimin e ndërmarrjes zbuluese të marrëveshjes së ndaluar në forme të lirimit apo zvogëlimit të masave ndëshkuese, tani ky privilegj është bartur edhe te shpërblimi i shkaktimit të dëmit. Kështu, ndërmarrjet zbuluese të marrëveshjes së ndaluar janë përgjegjëse vetëm ndaj blerësve të tyre direkt dhe indirekt<sup>65</sup>. Kjo ndërmarrje nga të dëmtuarit e tjerë mund të merret në përgjegjësi vetëm nëse ato nuk marrin kompensim të plotë nga ndërmarrjet e tjera të përfshira në kartel.<sup>66</sup> Një rregullim i tillë ka për synim që të shuaj frikën e ndërmarrjeve zbuluese se përkundër privilegjimit nga sanksionet administrative, të tillët mund të pësojnë në procedurë civile. Kjo është e arsyeshme kur dihet se shumica e marrëveshjeve të ndaluara zakonisht zbulohen nga vet pjesëmarrësit në marrëveshje të ndaluar.<sup>67</sup>

E drejta e Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare, të drejtën e legjitimitetit aktiv dhe pasiv, gjegjësisht të drejtës për të paditur dhe për të u paditur për dëmet e shkaktuara nga shkelja e dispozitave për mbrojtjen e konkurrencës, ia ka njohur një numri të madh të individëve që kanë pësuar dëme nga marrëveshjet e ndaluara. Njohja e këtyre dëmeve ka rritur efektin paralajmërues por mbi të gjitha ka plotësuar numrin e atyre që u është shkaktuar dëm. Kosova duhet të bëj ndryshime në drejtim të njohjes së legjitimitetit aktiv dhe pasiv për të dëmtuarit dhe shkelësit e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Rregullimi ligjor nuk e ngarkon buxhetin e shtetit, pasi po flasim

<sup>59</sup> Neni 2.2. Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326>

<sup>60</sup> Neni 11 (1). Direktiva 2014/104/BE.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>61</sup> Neni 190.1.: "Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht", Ligji Nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

<sup>62</sup> Neni 11 (2) a), Direktiva 2014/104/BE.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>63</sup> Ibid. Neni 11 (2) b).

<sup>64</sup> Ibid, Neni 11 (3) a), b).

<sup>65</sup> Neni 11 (4), Direktiva 2014/104/BE.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>66</sup> Ibid.

<sup>67</sup> Rast shembullor aktualisht shërben zbulimi i marrëveshjes së ndaluar të prodhuesve gjerman të veturave, ku dyshohet se firma VË bëri zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara që ka pasur me firmat tjera si Audi, Porsche, BMË und Daimler- tani i njohur si "rrethi i 5-shës". Sipas mediave, kjo pesëshe që nga vitet e 90-ta ka mbajtur mbi 60 grupe punuese ku kanë marrë pjesë mbi 200 të punësuar në këto firma. Shih më gjërësisht Javorja gjermane Spiegel, <http://piegel.de/irtschaft/soziales/volksaegen-audi-porsche-bm-e-und-daimler-unter-kartellverdacht-a-1159052.html>



për rregullimin juridik-civil të shkaktimit të dëmit me rastin e shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

## 6. Çështje të rëndësishme procedurale

### Paditë e natyrës Follow-on

Me njohjen e së drejtës së të dëmtuarve për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga një marrëveshje e ndaluar lind problemi i të provuarit të shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe rrjedhimisht edhe dëmin e shkaktuar nga shkelja e ligjit. Në pamundësi të blerësve direkt dhe indirekt për të vërtetuar ekzistimin e shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe rrjedhimisht edhe kërkesës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar si shkak i marrëveshjeve të ndaluara, është parë nevoja që të gjendet një mekanizëm i cili do t`ua lehtësonte të dëmtuarve potencial të provuarit e shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Shumica e padive civile kundër shkeljes së ligjit paraqiten pas konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara, të njohura si Follow-on-Padi. Me këtë lloj të padive kuptojmë paditë civile për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, të cilat ngritën pas vendimit të autoritetit të konkurrencës, nga ku është konstatuar, sanksionuar dhe ndaluar ekzistimi i një karteli.<sup>68</sup> Për këtë qëllim, *acquis* i BE-së i ka obliguar gjykatat që vendimin përfundimtar të autoritetit -me të cilën konstatohet dhe sanksionohet ekzistimi i kartelit - të pranojnë si dëshmi të pakontestueshme për ekzistimin e saj. Të dëmtuarit/paditësit e kanë shumë më të vështirë të dëshmojnë ekzistimin e një marrëveshje të ndaluar, se sa një autoritet i konkurrencës i cili është i veshur me kompetenca të hetimit dhe gjithashtu disponon me staf për të përndjekur shkelësit e ligjit<sup>69</sup>. Një rregullim i tillë është mëse i nevojshëm edhe për Kosovën, ngase kjo të dëmtuarve u shërben si lehtësi gjatë procesit të të provuarit të ekzistimit të shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.<sup>70</sup>

### Të provuarit e lartësisë së dëmit të shkaktuar nga marrëveshja e ndaluar

Të provuarit e dëmit është njëri ndër sfidat më të mëdha gjatë procesit gjyqësor. Blerësit direkt duhet të provojnë çmimin hipotetik të rritur nga karteli si dhe rrethanat që dëshmojnë se edhe ata janë prekur nga një kartel, përderisa blerësit indirekt ndër të tjerash duhet të dëshmojnë edhe bartjen e çmimit që u është bërë në kurriz të tyre.<sup>71</sup> Prandaj, sipas direktivës nr. 2014/104/ BE, secili shtet ka autonomi të rregulloj vet mënyrën e të provuarit.<sup>72</sup> Mirëpo, direktiva kërkon që shkalla e të provuarit të mos jetë aq e lartë sa të vështirësoj deri në pamundësi të provuarit e dëmit.<sup>73</sup> Po ashtu, edhe gjykatave duhet t`u jepet mundësia të vlerësojnë dëmin e shkaktuar, natyrisht duke u bazuar në prova.<sup>74</sup>

Në lidhje me metodën e matjes së dëmit të shkaktuar, Komisioni Evropian në vitin 2013 ka lëshuar një udhëzues praktik për përcaktimin e lartësisë së dëmit për paditë për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga shkelja e dispozitave për mbrojtjen e konkurrencës (në rastin e BE-së: neni 101 apo 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian).<sup>75</sup> Përgjithësisht janë disa metoda të kuantifikimit të dëmit. Më e njohura dhe më e përdorura nga palët dhe gjykatat janë “metodat e krahasimit të tregjeve”. Sipas këtyre metodave të dhënat e vëzhguara (si çmimi, vëllimi i shitjes, fitimet ose variabla tjera ekonomik) në tregjet në kohë të mëhershme ose në tregje të papërfshira

<sup>68</sup>Kling M / Thomas S (2007). *Kartellrecht*, München. F. 853.

<sup>69</sup>Kling M / Thomas S (2007). *Kartellrecht*, München. F. 853.

<sup>70</sup>Wissenbach K. Schadensersatzklagen gegen Kartellmitglieder-Offene Fragen nach der 7. Novellierung des GWB. *Beiträge zum Transnationalen Wirtschaftsrecht*, Vëllimi 60. F. 22.

<sup>71</sup>Schweitzer H (2013). *Schadensersatz im Europäischen Kartellrecht*. Zentrum für Europäisches Wirtschaftsrecht. F.22. [jura.uni-bonn.de/fileadmin/Fachbereich\\_Rechtswissenschaft/Einrichtungen/Sonstige/Zentrum\\_fuer\\_Europaeisches\\_Wirtschaftsrecht/Schrift\\_enreihe/Heft\\_212\\_Schweitzer.pdf](http://jura.uni-bonn.de/fileadmin/Fachbereich_Rechtswissenschaft/Einrichtungen/Sonstige/Zentrum_fuer_Europaeisches_Wirtschaftsrecht/Schrift_enreihe/Heft_212_Schweitzer.pdf)

<sup>72</sup>Neni 17. Direktiva Nr. 2014/104.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0104&from=DE>

<sup>73</sup>Ibid.

<sup>74</sup>Schweitzer H (2013). *Schadensersatz im Europäischen Kartellrecht*. Zentrum für Europäisches Wirtschaftsrecht. F.22. [jura.uni-bonn.de/fileadmin/Fachbereich\\_Rechtswissenschaft/Einrichtungen/Sonstige/Zentrum\\_fuer\\_Europaeisches\\_Wirtschaftsrecht/Schrift\\_enreihe/Heft\\_212\\_Schweitzer.pdf](http://jura.uni-bonn.de/fileadmin/Fachbereich_Rechtswissenschaft/Einrichtungen/Sonstige/Zentrum_fuer_Europaeisches_Wirtschaftsrecht/Schrift_enreihe/Heft_212_Schweitzer.pdf)

<sup>75</sup> Komisioni Evropian. *Praktischer Leitfaden zur Ermittlung des Schadensumfangs bei Schadensersatzklagen im Zusammenhang mit Zuwiderhandlungen gegen Artikel 101 oder 102 des Vertrags über die Arbeitsweise der Europäischen Union*. [http://ec.europa.eu/competition/antitrust/actionsdamages/quantification\\_guide\\_de.pdf](http://ec.europa.eu/competition/antitrust/actionsdamages/quantification_guide_de.pdf)

nga marrëveshja e ndaluar shfrytëzohen si një pikë referimi për skenarin hipotetik që do të ekzistonte pa shkeljet.<sup>76</sup> Janë disa metoda të krahasimit, ndër më të njohurat janë:

- Krahasimi i tregut të njëjtë me tregun para ose pas shkeljes së dispozitave të konkurrencës (marrëveshjes së ndaluar) – krahasimi kohor i tregjeve;
- Krahasimi i një tregu tjetër nga ai ku është bërë shkelja, por të ngjashëm gjeografikisht– krahasimi gjeografik i tregjeve;
- Krahasimi i një tregu tjetër nga ai ku është bërë shkelja, por të ngjashëm për nga produkti ose shërbimi– krahasimi i tregjeve sipas produktit.
- Së fundi ekziston edhe mundësia e kombinimit të krahasimit kohor me krahasimin gjeografik ose të produktit – krahasimi i kombinuar.<sup>77</sup>

Përveç metodës së krahasimit ekziston edhe metoda e simulimit të tregut, ku informatat e marra nga tregu me anë të disa simulimeve të tregut synohet të arrihet çmimi hipotetik i rritur nga marrëveshja e ndaluar.<sup>78</sup> Metodatat në fjalë nuk janë të rregulluara ligjërish, por shfrytëzohen nga gjykatat dhe palët për të përlogaritur dëmin e shkaktuar nga marrëveshja e ndaluar.

Të provuarit se ka pasur shkelje të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe llogaritja e dëmit të shkaktuar janë njëra ndër pjesët më të vështira të përbarimit privat. Për këtë arsye, ligjdhënësi i BE-së ka pranuar padinë Follow-on për të dëshmuar shkeljen e dispozitave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës. Po ashtu Direktiva Nr. 2014/104/BE udhëzon shtetet anëtare që të përcaktojnë kritere sa më të lehta për përcaktimin e lartësisë së dëmit. Dispozitat e tilla assesi nuk duhet të paraqesin pengesë për të dëmtuarin dhe duhet të i lënë hapësirë gjykatës që të bëjë edhe një vlerësim vetanak të dëmit të shkaktuar. Pa këto pika, rregullimi i përbarimit privat në Kosovë do të ishte i mangët. Edhe pse Ligji për Procedurën Kontestimore ofron një bazë të mirë, natyra e kontesteve civile të konkurrencës ka disa veçori tjera, rregullimi i të cilave duhet të bëhet me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

---

<sup>76</sup>Ibid. F. 17.

<sup>77</sup>Ibid.

<sup>78</sup> Competition Competence Report. *Berechnung von Schadensersatzanforderungen*. European E & M Consultants. F. 3. [ee-mc.de/fileadmin/migrated/content\\_uploads/Kartell\\_Schadensberechnungen\\_03.pdf](http://ee-mc.de/fileadmin/migrated/content_uploads/Kartell_Schadensberechnungen_03.pdf)

## 7. Përmbledhje dhe rekomandime

Luftimi administrativ-publik sot nuk shihet si mekanizmi i vetëm që përdoret për mbrojtjen e konkurrencës nga marrëveshjet e ndaluara. Përkundër që roli i autoriteteve të konkurrencës vazhdon të jetë i një rëndësie thelbësore, përbarimi privat vazhdon të luaj rol të trefishtë, në radhë të parë kompensimin e plotë të të dëmtuarve. Por duke kryer këtë funksion, përbarimi privat ndihmon në paralajmërimin e ndërmarrjeve që të mos bashkohen në kartele, pasi përveç gjobitjeve nga autoriteti i konkurrencës, të njëjtit përballen edhe me padi të panumërta nga të dëmtuarit potencial, dëmshpërblimi i së cilës fillimisht është i pallogaritshëm dhe mund të tejkaloj shumëfish dënimin e shqiptuar nga autoritetet. Përbarimi privat ndihmon në mbrojtjen e konkurrencës dhe mbi të gjitha u mundëson të dëmtuarve që të kërkojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga një marrëveshje e ndaluar.

### Rekomandime

- ✓ Kosova si aspirante për t`u bërë anëtare e Bashkimit Evropian duhet të bëj ndryshime të thella ligjore në fushën e ekonomisë dhe veçanërisht në fushën e mbrojtjes së konkurrencës. Konkurrenca si shtyllë e BE-së është njëra ndër fushat më të rregulluara nga Bashkimi Evropian dhe njëherit njëri ndër kushtet kryesore që duhet plotësuar për t`u integruar në këtë organizatë.
- ✓ Ligjdhënësi kosovarë duhet të bëj ndryshime sa më të shpejta të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Këto ndryshime duhet të orientohen drejt njohjes të së drejtës së të dëmtuarve për kompensimin e dëmit nga shkelja e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.
- ✓ Legjislacioni kosovarë mbi të drejtën e Konkurrencës duhet të njoh të gjitha llojet e dëmeve të shkaktuara nga shkelja e ligjit që rregullon mbrojtjen e konkurrencës. Veçanërisht duhet të njihen dëmet e shkaktuara bashkë-konkurrentëve dhe blerësve direkt, por edhe dëmet e shkaktuara blerësve direkt përmes bartjes së dëmit (passing on defense) dhe dëmet e shkaktuara nga efekti i umbrella pricing. Vetëm përmes njohjes së këtyre dëmeve mund të realizohet ndër parimet kryesore të konkurrencës së vendosur nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në rastin Courage, Manfredi dhe Kone, e që ua njeh të drejtën e kompensimit të dëmit “çdo individ që është dëmtuar nga shkelja e rregullave për mbrojtjen e konkurrencës”.
- ✓ Legjislacioni i Kosovës duhet t`ia njeh legjitimitetin pasiv ndërmarrjeve të përfshira në kartel. Ky rregullim veçanërisht duhet të marrë parasysh udhëzimet e direktivës së BE-së nr. 2014/104/BE, që parasheh disa përjashtime për ndërmarrjet që kanë zbuluar kartelin si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të përfshira në kartel, por që nuk mbulojnë më shumë se 5% të tregut. Këto rregulla kanë synim të mos rrezikojnë një ndër rregullat më të rëndësishme që ka ndihmuar në zbulimin e shumë karteleve siç është ai i bashkëpunimit të ndërmarrjeve të përfshira në kartel. Por gjithashtu, rregullat e lartcekura kanë synim të ruajnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që paraqesin shtyllën e ekonomisë evropiane, por edhe të Kosovës.
- ✓ Përfundimisht, kontestet e natyrës civile të konkurrencës kanë një natyrë specifike e cila kërkon rregulla të veçanta procedurale që dallojnë nga ato të së drejtës publike-administrative. Në këtë drejtim, ligjdhënësi kosovarë duhet të njoh vendimin e autoritetit të konkurrencës si dëshmi që ka pasur shkelje të caktuara në treg dhe mbi të gjitha, duhet të ofrohen kushte sa më të lehta për të dëshmuar dëmin e supozuar nga i dëmtuari. Gjykatave duhet t`u njihet e drejta të kenë mundësinë e vlerësimit të dëmit, duke u familjarizuar me metodat e përlogaritjes së dëmit të shkaktuar nga shkelja e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.
- ✓ Institucionet përkatëse duhet të rrisin buxhetin e Autoritetit, duke i mundësuar të rrisin numrin e stafit të tij hetues. Po ashtu, Kuvendi i Kosovës duhet të filloj të merret seriozisht me mbikëqyrjen e këtij rregullatori të konkurrencës me qëllim që Autoriteti të filloj të merret në përgjegjësi për punën e bërë.



*“Ky projekt është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”*

## **Analiza e Politikave**

Analizat e Politikave janë raporte që diskutojnë politikat publike dhe që synojnë të ndikojnë në vendimmarrje, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror të qeverisjes. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, të shqyrtoj argumentet e ndërlidhura me politikën përkatëse, dhe të analizojë zbatimin e saj. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjerë dhe gjithëpërfshirës mbi çështjen e dhënë, si dhe të ofroj zgjidhje të informuara dhe rekomandime për ndryshimin e politikave publike relevante, kryesisht drejtuar aktorëve dhe grupeve të interesit.



**GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES**

[legalpoliticalstudies.org](http://legalpoliticalstudies.org)